



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Datë 28.04.2023

Prot.73 (shtatëdhjetëtre)

Protokoll nr. 73

I mbajtur sot më datë 28.04.2023, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.03.2023;
3. P-V "Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin mars 2023";
4. P-V "Për miratimin e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë Maliq për muajin mars 2023";
5. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
6. P-V "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi subvencioni i intesave të kredisë për strehim";
7. P-V "Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullësor dhe krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të Bashkisë Maliq";
8. Shqyrtimi i kërkesave drejtuar Këshillit të Bashkisë Maliq.
9. Informacion për vendimarrjen dhe performancën e Këshillit të Bashkisë Maliq për vitin 2022.
10. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Rexhina Hëna; Ildir Limllari; Gentiana Drabo; Eriseld Jonusllari; Aleksandër Petriti; Pranvera Begolli; Floreta Zaçe; Kristiana Jonusllari; Jonilda Koçllari; File Qyrani; Erinda Xhaferllari; Armando Dautllari; Plator Çollaku; Valentina Pashollari; Dorjan Zholanji; Vasilika Trajko; Tefik Meçollari; Klement Zere; Dritan Çami; 20 (njëzetë) këshilltarë

Këshilltarë online në platormën ZOOM:

Enida Avdolli; Kristina Malelli; 2 (dy) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata:

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu; Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i Zyrës të Strehimit; Ledion Mullalli; Inxh i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave z.Petrika Theodhosi

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë këshilltarë, dua tju falenderoj për punën e kryer në këto 4 vite dhe dua tju uroj të gjithë suksese për garën e 4 viteve në vazhdim. Miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord ?



Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 20 vota me karton nga këshilltarët në sallë. Ju konfirmoj dhe kurumi realizohet, kemi 20 Këshilltarë në sallë dhe 2 online, vazhdojmë me rendin e ditës. Miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 20 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 2 online. Miratohet me 22 vota pro.

Ornildi Demollari: Po ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, janë gjithsej 4 vendime me karakter normativ dhe 8 me karakter kolektiv, nga vendimet me karakter normativ nuk janë konfirmuar 2 vendime nga Institucioni i Prefektit. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin mars 2023"; Ka ndonjë pyetje?

Pranvera Begolli: Kam unë diçka, kur qytetarët vijnë për të aplikuar për ndihmë, ju vendoset një barierë, pasi ne dimë që çdo kush mund të aplikojë, pastaj e vendos sistemi nëse i takon apo jo. Të jenë më kordet për pritjen e qytetarve pasi ka ankesa, ju thuhet që ke të ardhura dhe nuk të takon.

Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social znj. Ermenda Petriti: Shpresoj të kemi qenë bashkpunues me qytetarët, kur ata kanë mungesë dokumentacioni ne i orjentojmë se ku duhet të shkojnë të marrin dhe ti paraqesin, do shihen të gjitha rastet por duhet të kemi dhe bashkpunimin e personave që aplikojnë të kenë një sërë dokumentash.

Ornildi Demollari: Qartë, ka ndonjë pyetje tjetër? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 20 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 2 online. Miratohet me 22 vota pro. Ka diçka për Kryetarin se duhet të lëvizë për shkak të angazhimeve.

Kryetari i Bashkisë z. Gëzim Topçiu: Ka ardhur një kërkesë për mbështetje financiare nga 3 Studentë që kanë fituar një kurs të rëndësishëm, po ja kaloj Platorit për ti parë si ekspert, sot nuk do do doja të jepnim fonde, po në parim të biem dakord dhe pastaj ta shohim rast pas rasti. Janë tre vjaza nga Leminoti. Çau shlia, kanë fituar një trajnim të rëndësishëm, më vonë e shohim të lidhim një Akt-marrëveshje për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve. Do doja të falenderoj të gjithë anëtarët e Këshillit për bashkëpunimin që kemi patur dhe vendimarrjet që kemi marrë në shërbim të komunitetit. Shumë faleminderit!

Ornildi Demollari: Faleminderit Kryetar!

Tefik Meçollari: Për një aplikim që është bërë te fondi 6% z. Markelian Galla?

Ornildi Demollari: E kemi marrë parasysh, jemi te P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Bashkisë Maliq për muajin mars 2023"; Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 20 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 2 online. Miratohet me 22 vota pro. Jemi te pika 5 e rendit të ditës, P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"; I shoquruar P-V me familjet, ka ndonjë pyetje, koment?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 20 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 2 online. Miratohet me 22 vota pro. Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi subvencioni i intresave të kredisë për strehim": Bashkangjittur keni dhe materialin. ka ndonjë pyetje, koment?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 20 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 2 online. Miratohet me 22 vota pro pika 6. Falminderit! Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor dhe krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit vullnetar të Bashkisë Maliq"; Ka ndonjë pyetje për këtë, paqartësi? Inxh Tika do shtosh gjë? E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 20 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 2 online. Miratohet me 22 vota pro pika 7. Kemi dhe një P-V. Për shpenzime varrimi, për të ndjerën Myzejene Alushi, në vlerën 40.000 lekë, ja sygjeroj Këshillit ta kalojmë. Ermanda jepju Këshilltarve nga kopje. E kalojmë në votim?

Kush është dakord ?

Kundra?

Abstenim?

Korumi realizohet, miratohet me 20 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 2 online. Faleminderit! Miratohet me 22 vota pro. Pika 8 është shqyrtimi i kërkesave drejtruar Këshillit Bashkisë Maliq, kërkesa e parë është nga NJ.A Vreshtas, duka marrë nevojat dhe kërkesat e disa banorve të fshatit Podgorie për të lëvizur drejt qytetit të Korçës kërkojmë shtimin e disa orareve të linjës përkatëse, pasi oraret aktuale janë të pamjftueshme.

Pranvera Begolli: Kërkesa nuk na përket ne, i kalon administratës të Bashkisë.

Ornildi Demollari: Kërkesa tjetër vjete nga Z. Janaq Taçi babues në Zvirinë, kërkon që Shoqata Sportive Shën Triadha me 22 anëtarë, për të dy grupet sportive kërkojmë nga Bashkia mbështetje për complete sportive.

Pranvera Begolli: Kërkesa ti dërgohet administratës dhe të paraqitet me P-V.

Ornildi Demollari: Dhe u fundit është miratimi në parim për kërkesat që propozoj Kryetari, Plator mund të shtosh diçka?

Plator Çollaku: I pashë dhe mu dukën interesante, vizitova dhe Webin e tyre, ja vlen për ti ndihmuar këta të rinj.

Ornildi Demollari: Miratimi do bëhet në parim, mund të marrim një dakortësi në parim? Dakord! E fundit është, Informacion për vendimmarrjen dhe performancën e Këshillit të Bashkisë Maliq për vitin 2022. Duhet ta lexoj? Besoj e keni parë? Kjo ishte mbledhja. Faleminderit!

Mbledhja mbyllet!

